



KOMUNIKATË

CERTIFIKOHET LISTA E VOTUESËVE

23.10.2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës, ka mbajtur sot mbledhjen e 46-të me radhë. Në agjenden e takimit, është dhënë raporti i detajizuar lidhur me procesin e përpilimit të Listës Votuese, një nga projekte më kryesore të deritashme të organizimit dhe përgatitjeve të zgjedhjeve Lokale të 15 Nëntorit.

Besnik Buzhala, (Departamenti i Operacioneve Zgjedhore), ka referuar për Listën Votuese në detaje duke dhënë informacionet e nevojshme. Në përputhje me Ligjin Zgjedhor, ekipi i Shërbimit votues ka kryer një punë të gjatë dhe me interes për kompletimin e procesit përgatitor të zgjedhjeve.

Lista Përfundimtare Votuese 2009 (LVP 2009) për Zgjedhjet Lokale dhe për Kryetar të Komunave është bazuar në Ekstraktin e Regjistrimit Civil. Ky ekstrakt është përpiluar nga Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve (DPD), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Lista Përfundimtare Votuese 2009 përmban 1.563.741 emra të votuesëve të ndarë në 36 komuna, në 746 Qendra të Votimit dhe në 2256 Vendvotime. LPV përmban edhe emrat e të gjithë votuesëve me zotësi juridike të cilët kanë aplikuar me sukses në programin e votimit jashtë Kosovës. Përpilimi i Listës Votuese, është ndikuar nga faktor të caktuar siq është procesi i Decentralizimit që lidhet me formimin e 6 komunave të reja, përcaktimi i vendvotimeve të reja, në rekomandimet e bëra nga ana e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ). Prandaj, janë hapur 125 qendra të reja votuese. Gjithsejt 264.988 karta postare, u janë dërguar votuesëve të rinj dhe atyre që u është ricaktuar qendra për të konfirmuar se në cilin lokacion të votimit janë përcaktuar.

Të gjithë votuesit kanë pasë mundësi që të kontaktojnë Zyrat e Shërbimit Votues gjatë periudhës së shërbimit të votues. Gjatë kësaj periudhe 4538 votues kanë vizituar zyrat e KKZ-ve, 1550 votues kanë kërkuar nderimin e qendres së votimit. Prej këtyre kërkesave, 91 janë refuzuar: 60 votues janë refuzuar për arsye se Qendra Votuese në të cilat ata kanë kërkuar të votojnë nuk ka qenë përbrenda kufijve të komunës ku ata jetojnë, 5 votues janë

refuzuar për arsye se ata nuk kanë sjellë asnjë dokument identifikimi dhe 26 votues kanë aplikuar më shumë se njëherë për ndërrime dhe janë konsideruar si aplikues të dyfishtë.

Periudha e Kunsërshtimit dhe e Konfirmimit (22 shtator – 2 tetor), u ka mundësuar të gjithë votuesëve që ta sfidojnë LPV-në. Gjatë kësaj periudhe, 345 votues kanë konfirmuar të dhënat e tyre, dhe 21 kanë sfiduar LVP-në. Pas kësaj periudhe, Zyra e Shërbimit të Votuesëve ka marrë 16 vendime të gjykatave komunale, 5 prej këtyre kanë qenë kërkesa për largimin e personave të vdekur dhe që nuk figurojnë në LVP, 8 personave u është ri-caktuar qendrat e votimit dhe, 3 persona nuk janë aplikuar pasi që ata më nuk ishin në listën e votimit.

Votimi përmes Postës është ndërmarrë në periudhën 7 gusht, deri më 7 shtator, periudhë kjo që është zgjatur deri më 15 shtator. Rreth 10.000 aplikacione u janë dërguar kandidatëve për votim përmes postës në bazë të të dhënave të vitit 2007. Kurse 24.400 forma të tjera për aplikim janë dërguar në vende të ndryshme. Gjithsejt 2630 aplikacione kanë qenë të pranuar, prej të cilave 1.806 janë aprovuar dhe 824 janë refuzuar kryesisht për shkak të të dhënave jo të plota.

Gjithsejt, LPV përmbanë 1.563.741 votues. Bazuar në të dhënat e DPD-së, Zyra për Shërbimin Votues ka larguar 22.851 votues të vdekur nga LPV, 3000 të cilët nuk kanë marrë kurfar dokumenti të regjistrimit, **dhe 7 votues janë larguar nga lista sespe janë regjistruar dy herë.**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, e ka certifikuar Listën Votuese në bazë të nenit 64.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (Ligji nr. 03/L-037). Kryetarja znj. Nesrin Lushta, në emër të KQZ-së ka falënderuar për punën e madhe që është bërë Departamentin e Operacioneve Zgjedhore, ndërsa Lista Votuese është aprovuar unanimisht nga anëtarët e KQZ-së.

Në vazhdim të mbledhjes, KQZ ka shqyrtuar edhe rekomandimet e IFES-it lidhur me Informimin Publik. IFES ka propozuar rialokim të produkteve informative për periudhën 27 tetor – 15 nëntor. Propozimet kanë të bëjnë me zvogëlimin e posterëve për mënyrën e votimit për asamblenë komunale dhe për kryetar si dhe postaret me hapat e votimit (nga 60.000 në 30.000 për secilin poster), ndërsa të rritet numri i pamfleteve në 50%. Të zvogëlohet numri i reklamave në gazeta të disapores nga 17 në 7-10 ditë dhe, të mos publikohen reklamat fare në revista pasi që 300 reklama nga gjysmë faqe tashmë janë duke u publikuar në gazeta ditore. Sipas këtyre rekomandimeve, të hollat e kursyera nga këto shkurtime do të përdoren për fushatën motivuese: spotete në TV në dy gjuhë për dy javë, spotet në radio në 5 gjuhë për dy javë, printimi i 30.000 posterave motivues si dhe i pamfleteve motivuese (numri përcaktohet më vonë), reklamimi më i madh në televizione.

Komisioni Qendror Zgjedhor, i ka miratuar këto rekomandime të IFES-it duke marrë informacione dhe, pasi që i ka shqyrtuar ato.